



**KRYETARI I KOMUNËS**  
**MUNICIPAL PRESIDENT**  
**PRESDENIK OPSTINE**

Tel / Fax: 038/200-46002  
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.  
E-mail: [info.ferizaj@rks-gov.net](mailto:info.ferizaj@rks-gov.net)

|                       |                                                                                          |
|-----------------------|------------------------------------------------------------------------------------------|
| DATA/DATUM/DATE       | 21.07.2025                                                                               |
| NR/BR.                | 01.Nr.195/25                                                                             |
| PËR/ZA/TO             | Kuvendin e Komunës                                                                       |
| PËRMES/PREKO/THROUGH  | Komitetit për Politikë dhe Financa<br>Kryesuesit të Kuvendit të Komunës<br>Xhavit Zariqi |
| NGA/OD/FROM           | Kryetari i Komunës<br>Agim Aliu                                                          |
| LËNDA/PREDMET/SUBJECT | Propozim - Vendim për Subvencionimin e Transportit Urban dhe Urbano – Periferik.         |

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2, shkronja d) dhe nenit 40, paragrafi 40.2, e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Nr. 28/04 qershor 2008) Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 25 paragrafi 2, pika 2.9, neni 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50 dt. 28.06.2013, si dhe Ligjit për Transport Publik Ligji Nr. 04/L-179 16 maj 2013, Kryetari i Komunës i bën këtë:

### PROPOZIM - VENDIM

(Për Subvencionimin e Transportit Urban dhe Urbano – Periferik)

Me anë të këtij propozimi synohet të subvencionohet transporti urban dhe urbano-periferik si në vijim:

1. Subvencionimi i transportit urban dhe urbano-periferik, do të subvencionohet nga Komuna e Ferizajt në € për KM, të cilat do të llogariten në bazë të rendeve të udhëtimit.
2. Pas përfitimit të subvencionimit, do të formohet një komision me vendim të drejtorive përkatëse së bashku me operatorët transportues, do të bëjnë analizimin dhe negocimin e cmimores për bileta ditore dhe mujore si dhe unifikimin e tyre në transportin urban dhe urbano periferik.
3. Me anë të këtij vendimi Kuvendi i Komunës e autorizon Kryetarin dhe Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Emergjente Ferizaj.

### ARSYETIMI

Qëllimi i këtij propozimi është, Subvencionimi i Transportit Pubik të Udhëtarëve Urban dhe Urbano - Periferik në teritorin e Komunës së Ferizajt, i cili ka për qëllim përmirsimin e kushteve në tarnsportin e udhëtarëve si dhe ofrimin e shërbimeve sa më të sigurta dhe efikase në përdorimin e transportit publik, si dhe në mëshitetjen e kategorive, siç janë: nxënësit, studentët, pensionistët, kategoritë e dala nga lufta dhe personat me nevoja të veqanta.

Andaj kërkoi nga Kuvendi si i tillë të miratohet ky Propozim -Vendim.